



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Mars 2023

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Mars 2023

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në këtë edicion të këtij Buletini pasqyrohen aktivitetet për muajin mars të vitit 2023)

Fillon hartimi i Draftrregullores për shtesat e të punësuarve në sistemin prokurorial

Grupi punues për hartimin e draftit të Rregullores për shtesat e të punësuarve në sistemin prokurorial mbajti takimin e parë për hartimin e draftit të Rregullores për shtesat e të punësuarve në sistemin prokurorial.



Drafti i rregullores do të shërbejë për rregullimin e pagesës së të gjitha shtesave, të cilat do t'u takojnë të punësuarve në sistemin prokurorial, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik dhe në bazë të rregullores përkatëse.

Prokuroria Themelore në Gjilan, prokuroria më e suksesshme në Kosovë në trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të Strategjisë së sistemit prokurorial (2022-2024) dhe Planit të veprimit, Komisioni Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike vizitoi Prokurorinë Themelore të Gjilanit.



Me këtë rast shqyrtoi Raportin vjetor të Komisionit për vitin 2022 lidhur me kryerjen e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, trajtimin e tyre dhe sfidat e ndryshme të kësaj prokurorie që ka pasur për trajtimin e këtyre lëndëve.

Komisioni përgëzoi kryeprokurorin Arben Kadriu, për rezultatet e arritura në këtë prokurori, të cilat janë mjaft të kënaqshme. Po ashtu, kërkoi që përkushtimi i treguar në trajtimin e këtyre lëndëve gjatë vitit 2022 të vazhdojë edhe gjatë vitit 2023.

Mbahet takim për analizimin e aktiviteteve dhe sfidave në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku dhe Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, së bashku me një pjesë të anëtarëve të KPK-së, mbajtën një takim pune me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe me prokurorët e Njësitit për Korrupsion dhe Krime Ekonomike në kuadër të kësaj prokurorie.



Qëllimi i takimit ishte analizimi i aktiviteteve dhe i sfidave në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike përgjatë vitit 2022, si dhe diskutimi për zbatimin e Planit të Veprimit në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike për vitin 2022.

Rrjedhimisht, në këtë takim, u potencua nevoja për një angazhim më të shtuar në këtë drejtim, në mënyrë që të arrihen rezultatet e nevojshme gjatë zbatimit të planeve strategjike dhe planeve të punës, si dhe për të punuar lidhur me përputhjen e të dhënave statistikore të NJSHP-së me të ato të Prokurorisë Themelore të Prishtinës dhe të SMIL-it.

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe prokurorët e pranishëm, potencuan nevojën imediate për rritjen e numrit të prokurorëve në Njësitin për Korrupsion dhe Krime Ekonomike dhe për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit administrativ për normë orientuese.

Maloku priti në takim përfaqësuesit e Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ)

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës priti në takim ekipin e drejtuesve të Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ).



Takim u zhvillua në kuadër të diskutimeve për bashkëpunimin e Këshillit Prokurorial me Fondacionin Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ), fondacion ky, i cili ka ofruar dhe po ofron mbështetje të vazhdueshme në fuqizimin e sektorëve të ndryshëm në sistemin prokurorial.

Kryesuesi i KPK-së falënderoi përfaqësuesit e këtij Fondacioni gjerman, duke theksuar përkrahjen e pakursyer të tyre për të dhënë kontribut të çmueshëm në fusha të ndryshme, veçanërisht në ngritjen e cilësisë së komunikimit publik dhe krahas kësaj, ky bashkëpunim është edhe më i zgjeruar në zbatim të projektit EUKOJUST.

SMIL-i, prioritet i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive mbajti takimin e radhës, me ç'rast aprovoi Planin e monitorimit të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) për të gjitha prokuroritë për vitin 2023.



Qëllimi i aprovimit të këtij plani është largimi i raporteve manuale që përgatiten nga stafi i prokurorive, zbatimimi i raporteve që gjenerohen nga SMIL dhe ngritja e cilësisë së shënimeve.

Nënshkruhet deklarata e përbashkët e zotimit për reformën në sistemin e drejtësisë

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit nënshkruan Deklaratën e Përbashkët të Zotimit së bashku me institucionet e tjera shtetërore për reformën ligjore në sistemin e drejtësisë në Kosovë.



Deklarata u nënshkrua ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorit të Shtetit, e cila ka për qëllim intensifikimin dhe konkretizimin e veprimeve të përbashkëta drejt avancimit të mëtejshëm të fuqizimit të sundimit të ligjit në Kosovë.

Këto institucione të larta të drejtësisë në Kosovë morën përsipër dhe u zotuan që, përmes këtij akti të nënshkruar, të themelojnë grupe të përbashkëta punuese për një sërë çështjesh të rëndësishme për reformën e sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Në këtë aspekt përfshihet vlerësimi, konceptualizimi dhe draftimi i nismave ligjore, me qëllim të qartësisimit, amendamentimit dhe fuqizimit të kuadrit ligjor në fushat që ndërlidhen me vlerësimin e performancës, procesin e rekrutimit, emërimit dhe rëmërimit, sistemin e disiplinimit, zhvillimin profesional dhe statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, forcimin e mekanizmave për deklarim të pasurisë së prokurorëve dhe gjyqtarëve, sistemin e verifikimit të profilit të kandidatëve për prokurorëve dhe gjyqtarëve, si dhe zbatimin e rekomandimeve nga misioni TALEX për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit (2022).

Në të gjitha këto veprime ndërinstitucionale do të ketë bashkërendim të plotë me partnerët ndërkombëtarë.

Organizohet dhurimi vullnetar i gjakut në sistemin prokurorial

Në kuadër të aksioneve të shpeshta humanitare, pothuajse në çdo gjashtëmuor, për dhurimin e gjakut për nevojat e qytetarëve të vendit, Këshilli Prokurorial

i Kosovës, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut, organizuan dhurimin vullnetar të gjakut, me ç'rast kësaj nisme iu përgjigjen pozitivisht një numër i konsiderueshëm i punonjësve.



Dhurimi i gjakut është bërë tashmë një traditë në sistemin prokurorial, ngaqë, të paktën, 2 herë në vit organizohet një nismë e tillë humanitare.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike

Komisioni Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike mbajti takimi e radhës, në të cilin anëtarët e tij u njoftuan për takimin e mbajtur nga Kryesuesi i KPK-së dhe Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore të Prishtinës dhe prokurorët e Njësitit për Korrupsion dhe Krime Ekonomike në kuadër të kësaj prokurorial lidhur me analizimin e aktiviteteve dhe të sfidave në luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike përgjatë vitit 2022 dhe fillimit të vitit 2023, si dhe diskutimin e zhvilluar për zbatimin e Planit të Veprimit në Luftimin e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike për vitin 2022-2024.



Gjithashtu u shqyrtua kërkesa për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ për Caktimin e Normës Orientuese për Prokurorët e Shtetit, e cila do

t'i dërgohet për shqyrtim Komisionit për Çështje Normative.

Dekretohen 21 prokurorë të rinj

Pas propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Presidentja e Republikës së Kosovës, dekretoi 21 prokurorë të rinj me mandat fillestar për tri vjet.

Në ceremoninë e betimit, prokurorët e rinj janë betuar se do t'i qëndrojnë besnikë Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve në fuqi dhe do të respektojnë rregullat e etikës profesionale.



Pas ceremonisë së dekretimit, prokurorët e rinj janë pritur në takim nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Ushtuesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të cilët uruan prokurorët e rinj për dekretimin dhe kërkuan nga ta angazhim dhe profesionalizëm gjatë ushtrimit të mandatit të prokurorit të Shtetit.



Prokurorët e rinj do të sistemohen në shtatë prokuroritë themelore të Republikës së Kosovës.

Mbahet Takimi i 228-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës mbajti takimin e 228-të me radhë, me ç'rast themeloi panelin hetimor për rastin disiplinor ndaj një prokuroreje të Prokurorisë Themelore në Prizren dhe miratoi Raportin vjetor të Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2022.

Gjithashtu miratoi edhe Raportin për aktivitetet dhe rekomandimet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik për periudhën tetor-dhjetor 2022, Raportin përmbledhës mbi vlerësimin e eprorëve për prokurorët me mandat të përhershëm për vitin 2022 dhe raporti i Komisionit përkatës për avancimin e një prokurori nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prizren, si dhe ka refuzuar kundërshtimin e një kandidati të paraqitur ndaj të njëjtit raport.



Aprovoi edhe kërkesën e Zëvendëskryesuesit të KPK-së për lirim nga detyra e kryesuesit të Komisionit Mbikëqyrës për Rastet e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, ndërsa në vend të tij zgjodhi anëtarin e Këshillit Prokurorial nga radhët e Prokurorisë së Apelit, dhe aprovoi kërkesën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për transferimin e përkohshëm të një prokurori nga Departamenti për të Mitur në Departamentin për Krime të Rënda, kurse lidhur me kërkesën e Odës së Avokatëve për ndryshimin e Udhëzimit Administrativ për Procedurat për Kompensimin e Mbrojtësve me Shpenzime Publike vendosi që ajo të dërgohet për shqyrtim në Komisionin për Buxhet dhe pastaj të procedohet edhe në Komisionin për Çështje Normative dhe të vendoset për të në njërin nga takimet e ardhshme të KPK-së.

Anëtarët e KPK-së aprovuan dorëheqjen e Ushtuesit të Detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së, pas dekretimit të tij për prokurorë të shtetit dhe caktuan Ushtuesen e re të Detyrës së SKPK-së me një mandat tremujor dhe mori vendim për të dërguar propozimin tek presidentja e vendit për ta liruar nga detyra një prokuror me rastin e arritjes së moshës së pensionimit të tij.

Kryesuesi Maloku priti në takim përfaqësueset e Sektorit të Sundimit të Ligjit në Ambasadën e Britanisë së Madhe

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës priti në takim lamtumirës udhëheqësen e Sektorit të Sundimit të Ligjit

në Ambasadën e Britanisë së Madhe dhe pasuesen e saj në këtë detyrë.



Kryesuesi i KPK-së falënderoi Udhëheqësen e deritashme të Sektorit të Sundimit të Ligjit në Ambasadën e Britanisë së Madhe për punën dhe angazhimin e saj të pakursyer lidhur me fuqizimin e sistemit prokurorial, duke shprehur, gjithashtu, edhe përkushtimin e tij për bashkëpunim e ngushtë me udhëheqësen e re të këtij sektori, në mënyrë që të avancohen proceset që janë në funksion të sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Bashkëbiseduesit diskutuan edhe për reformat në sistemin prokurorial të Kosovës dhe mënyrat e ofrimit të mbështetjes së nevojshme në proceset që kanë për qëllim tejkalimin i vështirësive dhe sfidave në sistemin prokurorial.

Deklaratë e Këshillit Prokurorial lidhur me rrëzimin e Ligjit për KPK-në nga Gjykata Kushtetuese

Këshilli Prokurorial i Kosovës deklaroi se publikimi i Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës për Ligjin e Këshillit Prokurorial, të cilin e ka shpallur kundërkushtetues dhe e ka rrëzuar përfundimisht, vërteton plotësisht qëndrimet dhe shqetësimet e shprehura publikisht të përfaqësuesve të sistemit prokurorial, në mënyrë që ky ligj të mos miratohej si i tillë.



KPK-ja, theksoi se edhe pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese është keqpërdorur sërish fjala e lirë, keqpërdorim ky, i cili është dhe mbetet kryekëput jashtë të drejtës demokratike dhe aq më tepër kur ai vjen nga zyrtarët më të lartë të shtetit. Edhe sot u dëgjuan deklarime të tilla nga Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në konferencën për medie, të cilat përkrijnë me një pamaturë dhe joseriozitet aq të theksuar sa që shkojnë deri në kontestim të akteve që dalin nga institucioni më i lartë kushtetues, duke pohuar se “më e rëndësishmja për të është interesi individual i disa anëtarëve të KPK-së” dhe përtej saj, një zyrtare e lartë e Qeverisë, për çudi, nuk pajtohet me vendimin e një institucioni më të lartë, siç është Gjykata Kushtetuese.

Paraprakisht, për hir të transparencës publike, KPK-ja, ka shprehur disa herë para opinionit qëndrimin e vet me anë të deklaratave dhe reagimeve të njëpasnjëshme për një mbarëvajtje jo të rregullt të procesit të hartimit të Projektligjit të KPK-së dhe për futjen e elementeve tendencioze dhe jofunksionale, si dhe për nxitimin marramendës të Ministrisë së Drejtësisë dhe Qeverisë për të proceduar e miratuar këtë Projektligj, pa e konsultuar draftin final me aktorët e këtij procesi dhe pa i pritur komentet shtesë të Komisionit të Venecias.

Gjithashtu, KPK-ja, ka përmendur sistematikisht defektet e shprehura të Ekzekutivit lidhur me mosmarrjen parasysh të propozimeve të dala nga Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe propozimeve të përfaqësuesve të sistemit prokurorial dhe akterëve të tjerë të sistemit të drejtësisë ose jashtë tij, gjë që realisht përbënte hapur një tendencë për të cenuar pavarësinë e KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit, si institucione të pavarura dhe kushtetuese.

Në këtë kontekst, rrjedhimisht, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës hoqi të gjitha dilemat ekzistuese lidhur me këtë çështje, së pari, duke marrë vendim që të rrëzohet komplet Ligji për Këshillin Prokurorial dhe, së dyti, duke parandaluar cenimin e pavarësisë së KPK-së dhe ligjësimin e ndikimeve politike në sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës.

KPK-ja pohoi se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, me nxjerrjen e këtij vendimi të drejtë, afirmon njëherë e mirë të drejtën kushtetuese për mosinterferim politik, i cili cenon thelbësisht pavarësinë e prokurorëve të shtetit dhe përgjithësisht pavarësinë e sistemit prokurorial.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, deklaroi se mbetet i përkushtuar për të mbështetur proceset e përgjithshme reformuese në sistemin prokurorial dhe do të bëjë

përpjekje edhe në të ardhmen që së bashku me të gjithë mekanizmat shtetërorë të vendit, mbështetësit

dhe partnerët e çmuar ndërkombëtarë, të bashkëveprojë në çdo lloj nisme legislative dhe nisma të tjera, që kanë për qëllim reformimin e nevojshëm, në mënyrë që të fuqizohet sundimi i ligjit në Kosovë dhe sistemi prokurorial i Kosovës të bëjë punën e vet të pavarur, profesionale, transparente, duke mos u ekspozuar para asnjë lloji ndërhyrjeje apo presioni nga palët e ndryshme.

Prokurori Arian Gashi emërohet Kryesuesi i Komisioni Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike

Komisioni Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike ka mbajtur takim të radhës, me ç' rast është bërë dorëzim-pranimin e detyrës së kryesuesit të këtij komisioni nga kryesuesi i deritashëm tek kryesuesi i ri, anëtar i KPK-së nga radhët e Prokurorisë së Apelit.



Këshilli Prokurorial i Kosovës në Takimin e 228-të miratoi dorëheqjen e kryesuesit të deritashëm të Komisioni Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike dhe në të njëjtin takim zgjodhi kryesuesin e ri të këtij komisioni.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Çështje Normative

Komisioni për Çështje Normative mbajti takimin e radhës, me ç' rast shqyrtoi draftin e Rregullores për shtesat dhe kompensimet për të punësuarit në sistemin prokurorial, ku përcaktohen kriteret, kushtet, rregullat, mënyra e llogaritjes dhe procedura për përfitimin e shtesave dhe kompensimet për të gjithë të punësuarit në sistemin prokurorial.



Me këtë rast, anëtarët e Komisionit theksuan se me hyrjen në fuqi të Ligjit për paga në sektorin publik, është përcaktuar se sa i përket procedurës, kritereve dhe kushteve për kompensime dhe shtesa për të punësuarit në sistemin prokurorial duhet bërë rregullimi me akte të brendshme, andaj drafti i këtij akti është i rëndësishëm së veçantë për sistemin prokurorial.

Anëtarët e Komisionit për Çështje Normative takuan ekspertët e projektit EUKOJUST

Komisioni për Çështje Normative ka mbajti një takim me ekspertët e projektit EUKOJUST.



Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi i draftit fillestar të Planit për sistematizimin, digjitalizimin dhe automatizimin e arkivave për Këshillin Prokurorial të Kosovës, plan ky, i përgatitur nga eksperti Simone Ginzburg, ku u dhanë edhe komentet dhe sugjerimet e nevojshme lidhur me finalizimin e këtij plani, si dhe u propozua që në takimin e radhës të ketë pjesëmarrje më të gjerë, duke përfshirë përfaqësuesit e Agjencisë Shtetërore të Arkivave dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me qëllim të shkëmbimit dhe unifikimit të procedurës për ruajtjen, transferimin, asgjësimin e regjistrave dhe lëndëve, si dhe listës me afate të ruajtjes së dokumenteve arkivore, të krijuara nga sistemi prokurorial.

Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

Sekretariati i KPK-së, gjatë muajit mars, ka nënshkruar kontratën nga UNDP-në me operatorin e përzgjedhur për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e uebportalit të ri për sistemin prokurorial të Kosovës, përmes së cilës planifikohet të bëhet zhvillimi i një portali të ri.

SKPK-ja ka përfunduar rishikimin e Planit të trajnimeve për nëpunësit për vitin 2023, si dhe ka mbajtur takim me përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, ku është diskutuar Plani i punës për monitorimin e zbatimit të SMIL-it në të gjitha prokuroritë.

Në kuadër të ngritjes dhe përforsimit të kapaciteteve profesionale ka pasur pjesëmarrje në punëtorinë e organizuar nga Projekti EukoJust me temën: “Reforma ligjore në sistemin e drejtësisë nga perspektiva e sistemit gjyqësor dhe prokurorial”, si dhe është ndjekur trajnimi profesional për fushën e TI-së në lokalet e kampusit të AUK dhe ka vazhduar ofrimin e trajnimeve për vënien në zbatim të SMIL-it në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe prokurorive përkatëse.